



INFORMACIONE

Nëntor - Dhjetor 2006

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Rruga: "Muhamet Gjollësia", Sheshi "M.Q. Atatürk", Tiranë

Tel. +355 235249/240602 Fax. +355 240565

E-mail: secretariat@nocalbania.org.al - www.nocalbania.org.al

Jo dhunës !



Dhuna e Përsëritur në Stadiumet Shqiptare (Deklaratë Shtypi e datës 12 Nëntor 2006)

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar shpreh shqetësimin e thellë për dhunën e shfaqur në stadiumet shqiptare në ndeshjet e Kampionatit Kombëtar të Futbollit!

Nisur nga ngjarja më e fundit, ndodhur në Qytetin e Burrelit, në ndeshjen Burreli-Erzeni, ku përfaqësuesi i FSHF z. Sulejman Mema, vuan sot rrjedhjen e veprimeve të dhunshme, që cuan në gjendjen e përkeqësuar shëndetësore të tij, është një detyrë qytetare dhe civile e cdo anëtarit të Lëvizjes Sportive Olimpikë dhe të shoqërisë shqiptare të dënojë dhe të mbajë qëndrim ndaj dhunës dhe ushtrive të saj.

Në sport apo në jetën tonë të përditëshme, qëniet njerëzore zgjedhin, vuajnë ose imponojnë sjelljet e tyre. Në konkurrencë, ekuilibri ndërmjet vetëkontrollit dhe impulsivitetit, të respektuarit apo devijimi nga sjellja e rregullt, është një gjë shumë delikate. E tillë është jeta jonë, dhe vetëm shpirti i tolerancës dhe i etikës mund të ndihmojë në mbajtjen e kornizave të duhura etike.

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar shpreh shqetësimin për mungesën e Fair Playt dhe Cënimit e dukshëm të sigurisë së qytetarit në mjediet futbolistike. Është ky një fenomen ndaj të cilit duhet vepruar dhe reaguar shpejt, dhe me eficiencë për të mos lejuar që evenimentet sportive, të kompromentohen në misionin e tyre.

Kryetarë të Bashkive, shefa të Klubeve të Futbollit dhe Klubeve Shumësportësh, përfaqësues të Rendit, qytetarë dhe sportistë, i thoni "Jo Dhunës" në cdo trajtë të saj, dhe MOS u bëni mbrojtës të denigrimit të vlerave njerëzore. Përfaqësues të Shtetit dhe të institucioneve më të larta Sportive e shoqërore, përmbushni misionin tuaj, duke reaguar në nisma që të tilla ngjarje të parandalohen!

Në emër të Jetës dhe në shërbim të dinjitetit njerëzor, KOKSH kërkon reagimin tuaj pro aktiv për të thënë "Jo Dhunës në Stadiume".

KOKSH uron z. Mema për shërim të shpejtë dhe rekuperim të plotë, dhe distancohet në mënyrë të qartë nga motivet dhe veprimet e patolerueshme të dhunës!

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

" C I T I U S A L T I U S F O R T I U S "

Jo dhunës !



16 Nëntor 2006 - Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH në mbledhjen e Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport

Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, si anëtar i Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport, (strukturë e ngritur nga Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve me vendim të Këshillit të Ministrave datë 13.01.2006), mori pjesë në mbledhjen e parë e cila u zhvillua pranë MTKRS në datën 16 Nëntor 2006. Në këtë mbledhje u diskutua për masat parandaluese dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për parandalimin e fenomeneve të dhunës gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive.

hjen e parë e cila u zhvillua pranë MTKRS në datën 16 Nëntor 2006. Në këtë mbledhje u diskutua për masat parandaluese dhe bashkëpunimin ndërinstitucional për parandalimin e fenomeneve të dhunës gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive.



Presidenti i KOKSH dhe Sekretari i Përgjithshëm në punimet e Tryezës, organizuar nga MTKRS

22 Dhjetor 2007 - Tryezë e MTKRS Kundër Dhunës

Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH morën pjesë në TAVOLINEN E RRUMBULLAKET PER PROBLEME TE DHUNES NE SPORT organizuar nga MTKRS, në "Tirana International Hotel". Stavri Bello referoi në emër të KOKSH temën **"Rëndësia e punës në Partneritet në parandalimin**

e dhunës në Sport". Presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar z. Hysen Domi, në përfshirjen e tij aktive në punimet e Tryezës, ritheksoi fuqishëm rëndësinë e koordinimit ndërinstitucional, dhe ofroi bashkëpunim të kurdohershëm të KOKSH për të parandaluar fenomenin dhunë në sport.

SOLIDARITETI OLIMPIK



KURSI TEKNIK I KUALIFIKIMIT TE TRAJNEREVE TE BASKETBOLLIT NIVELLI II

KOKSH ne bashkepunim me FSHB organizuan Nivelin e dytë të Kursit Teknik për Trainerët e rinj të Basketbollit. Ky kurs që financohet nga Solidariteti Olimpik është vazhdimësi e kursit të nivelit të parë të zhvilluar në dhjetor të vitit 2005.

Ky Program Botëror 4-vjeçar 2005-2008 ka për qëllim formimin e vazhdueshëm të trainerëve dhe arritjen e një trajnimi standart, cilësor dhe bashkëkohor, në të gjithë botën. Njëkohësisht, këto kurse do të do të ndihmojnë në ngritjen e një sistemi për kualifikimin e trajnërëve në nivel kombëtar.



Pjesëmarrësit në seminar / Basketboll

Per te drejtuar kete kurs dy javor SO erdhi në Shqipëri eksperti i FIBA-s z. Mario De Sisti i cili drejtoi edhe nivelin e parë të këtij kursi. Kursi i zhvillua në mjediset e pallatit të Sportit "Farie Hoti" në Tiranë, i ndarë në seanca të paraditës dhe pasdites, në datat 11-23 Dhjetor 2006.



ZHVILLIMI I STRUKTURES KOMBETARE SPORTIVE PER SPORTIN E ATLETIKES SEMINAR KOMBETAR ME TRAJNERET E ATLETIKES



Pjesëmarrësit në seminar / Atletikë

KOKSH në mbështetje të Sportit të Atletikës – Projekti “Zhvillimi i Strukturës Kombëtare Sportive”, në kuadër të projekteve të vazhdueshme të mbështetura nga Solidariteti Olimpik,

në vijim të strategjisë së tij (së KOKSH) afatgjatë për përmirësimin, kualifikimin, dhe formimin e vazhdueshëm të kuadrove specialistë dhe trainerë, zhvillon projektin “Zhvillimi i Strukturës Kombëtare Sportive” duke bërë të mundur ardhjen e një eksperti të huaj në mbështetje të sportit të Atletikës për garat e shpejtësisë 100m, 200m, 400m dhe pikwrisht IAAF ka sjellë në Shqipëri Ekspertin Francez me shumë eksperiencë z. Ferdinand Urtebise.

Ardhja e tij konsistoi në trainimin dhe asistencën trainerëve të atletikës për disiplinën e grave të shpejtësisë. Z. Urtebise asistoi nga afër seancat stërvitore në klubet e qyteteve dhe organizoi në Tiranë seminarin 1 javor me të gjithë trainerët kombëtarë të Atletikës në datat 4-9 Dhjetor 2006, në datat 30 Nëntor – 2 Dhjetor 2006 – Klubi “Skënderbeu”, Korçë; në datat 11-13 Dhjetor 2006 – Klubi “Vllaznia”, Shkodër; dhe në datat 14-15 Dhjetor 2006 – Mjeshtria Sportive Durrës & Klubi “Teuta”, Durrës

20-22 Nëntor 2006 – Kursi Lokal i Administratorëve Sportivë, Burrel



Pjesëmarrësit në kursin Lokal të Administratorëve Sportivë, Burrel

KOKSH në vijim të projekteve për informimin dhe azhurnimin e drejtuesve lokalë sportivë me të rejtat dhe

mënyrat bashkëkohore të Menaxhimit Sportiv, ka organizuar në Kursin Lokal të Administratorëve Sportivë në qytetin e Burrelit. Tematikat e trajtuara në këtë kurs dhanë një tablo informuese mbi mënyrat dhe metodat bashkëkohore të menaxhimit dhe administrimit sportiv, aspekte ligjore, teknologjia, hartimi dhe zbatimi i projekteve, planifikimi, etj. Pjesëmarrës në kurs ishin drejtues të Klubit Burrel, trainerë, mësues të edukimit fizik. Ky kurs ishte në vëmendje të Presidentit të KOKSH z. Domi, Deputetit të qytetit të Burrelit z. Qemal Minxhozi, Bashkisë Burrel dhe Kryetarit z. Skënder Lleshi si dhe Klubit Shumësportësh Burrel.



10-12 Nëntor 2006 - Seminari Teknik "Rruga për në Pekin 2008", Stamboll TUR.

Komisioni Teknik i Komitetit Olimpik European në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Turk organizuan në Stamboll të Turqisë në datat 10-12 Nëntor 2006 Seminarin e 7-të Teknik me temë **"Rruga për në Pekin – Sfidat dhe Mundësitë për Komitetet Olimpikë Europiane"**.

Delegatë nga 41 Komitete Olimpikë Europiane morën pjesë dhe ndoqën me interes këtë seminar, i cil ishte nje sukses i vertetë si për nga pjesëmarrja dhe nga standarti i organizimit ashtu edhe nga brenmdia informative e seminarit.

Për KOKSH ky seminar u ndoq nga Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello i cili është njëkohësisht edhe Sekretar i Komisionit Teknik të COE dhe Kryetari i Komisionit Teknik të KOKSH z. Fidel Ylli.

27-30 Nëntor 2006 – ICMG – Seminar mbi Marketingun Olimpik



Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH-it në referimin e tij në seminarin e ICMG-së

Nga data 27-30 Nëntor, u zhvillua në Athinë të Greqisë, Seminari i parë i Marketingut për vendet mesdhetare në kuadër të ICMG. Në këtë Seminar Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello referoi temën: **"Marketingu i Komitetit Olimpik Shqiptar / Një Strategji e Qëndrueshme"**. Ndër temat e tjera që u referuan nga eksperti Slloven D. Pintar, ishin: "Si të gjejmë një sponsor", "Lidhja kontraktuale me Sponsorin", etj. Të pranishmit, përfaqësues të Komiteteve Olimpikë Mesdhetare shfaqën interes për të organizimin e seminareve të tilla të cilat midis të tjerave krijojnë mundësinë e shkëmbimit të eksperiencave të ndryshme.

** KOKSH disponon materialet e referuara në mënyrë elektronike në gjuhën angleze.*

17 Nëntor 2006 Trofeu Olimpik "Sporti & Komuniteti" komunës Gjinar (Elbasan)



Trofeu iu dhurua kryetarit të Komunës z. nga Presidenti i KOKSH z. Domi

Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi dhe stafi i KOKSH morën pjesë në aktivitetin artistik-fizkulturore që u zhvillua në kuadër të festimit të dhënies së Trofeut Olimpik, akorduar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar për Komunën e Gjinarit e quajtur "Sporti dhe Komuniteti". CIO e ka përzgjedhur Komunën e Gjinarit për kontributin e saj në përhapjen e frymës dhe parimeve Olimpike duke organizuar çdo vit "Ditën Olimpikë të Malit" Bukanik. Trofeu iu dhurua kryetarit të Komunës z. nga Presidenti i KOKSH z. Domi. Në ceremoninë e rastit morën pjesë përfaqësues të Bashkisë Elbasan, Drejtorisë Arsimore, Mësues të Edukimit Fizik, etj.

Pritja në KOKSH e FSHF dhe Michel Platini

8 Nëntor 2006 Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello dhe Shefi i Misionit i Lojrave Olimpikë Verore z. Fidel Ylli, pritën në një takim zyrtar, z. Michel Platini dhe përfaqësuesit më të lartë të Federatës Shqiptare të Futbollit.

Në kuadër të kësaj vizite, z. Bello shprehu kënaqësinë e vecantë që FSHF dhe z. Platini ishin në KOKSH, edhe për faktin se kjo vizitë bëhej në kuadër të nis-mave dhe projekteve që do të shërbejnë rinisë shqiptare. "Duke qënë se infrastruktura e futbollit, për nga misioni i saj, do t'i shërbejë të bërit sport edhe të rinjve të tjerë, KOKSH është shumë i kënaqur për këto projekte! Është e rëndësishme që rinia të ketë mundësinë të zhvillojë sport në infrastrukturë sa më bashkëkohore, dhe për këtë Lëvizja Olimpikë është shumë e kënaqur".

Nga ana e tij z. Platini falënderoi për mikpritjen e përzemërt dhe shprehu kënaqësinë e vecantë për vizitën në KOKSH dhe takimin me përfaqësues të tij. Për të është shumë e rëndësishme që fëmijët të bëjnë sport dhe që infrastruktura e futbollit mund të shërbejë për të bërë sporte të ndryshme të gjithë të rinjtë. Të rinjtë janë e ardhmja dhe kjo është e shkëlqyer.

Në këtë bisedë ku u fol se KOKSH do të bashkëpunojë për projektet dhe do të mbështesë FSHF-në për projekte të Kualifikimit të trainerëve, pasi trainerët kanë një jetë shumë të gjatë në sport, ndoshta më të gjatë se sportistët, Michel Platini shprehu kënaqësinë



Fidel Ylli, Stavri Bello, Mishel Platini dhe Armando Duka në takimin në KOKSH

që vizitonte për herë të katërt Shqipërinë, dhe foli për marrëdhëniet e shkëlqyera që Presidenti i federatës Botërore Jozef Blater dhe Presidenti i CIO Jacques Rogge kanë, duke vënë theksin tek pavarësia e veprimit të këtyre institucioneve.

Në fund pas bisedës miqësore, dhe kortezinë e shprehur edhe nga Shefi i Misionit Fidel Ylli, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, dorëzoi z. Platini simbolikën e kristaltë me Heroin Tonë Kombëtar "Gjergj Kastrioti". Foto e përbashkët mbylli këtë takim të vecantë në KOKSH.

SEANCE e KAS (Keshilli i Arbitrazhit Sportiv)



Përfaqësuesit e FSHF dhe Futboll Klub Burrelit në Seancën e KAS

07/12/2006 K.A.S (Këshilli i Arbitrazhit Sportiv) u mbledh për shqyrtimin e çështjes me palë : Ankues: Futboll Klub "BURRELI" Kundra: Federata Shqiptare e Futbollit, Me objekt: Ndryshimin e vendimit nr. 853 dt. 25/11/2006 të Komisionit të Apelit të F.SH.F. duke përcaktuar si masë dënimi atë maksimale të parashikuar në nenin 24/1,2,3. i K D S.

Vendimi i KAS në përfundim të senacës është:

KAS vendosi të pranojë kërkesën e Ankuesit për uljen e masës së dënimit, duke ndryshuar pikën 1 gërma a) të vendimit të komisionit të disiplinës së FSHF datë 15.11.2006 dhe atë të Komisionit të Apelit të FSHF datë 27.11.2006 në bazë të së cilës Futboll Klub Burreli përjashtohet nga Kampionati dhe cdo veprimtari tjetër zyrtarë për 1 vit, si dhe uljen në një kategori më të ulët.

KOKSH në Kongresin Botëror të Sportit për të Gjithë

Në Havana të Kubës, në datat 31 Tetor – 3 Nëntor u mbajt Edicioni i 11-të i Kongresit Botëror të Sportit për të Gjithë. Ekspertë nga e gjithë bota debatuan për çështjen më kryesore: "Aktiviteti fizik: Përfitimet dhe Sfidat", temë që është promovuar për kohë të gjatë dhe që përfshin të gjitha moshat, gjinitë, ndryshimet sociale, fizike, mendore dhe kushtet ekonomike për të arritur kushtet për një aktivitet të rregullt fizik është një sfidë. Në kongres u prezantuan studime të ndryshme në kontribut të Sportit për të Gjithë, sfidat që hasen në shoqërinë moderne, zhvillimi, edukimi, etika, integrimi social, solidariteti, toleranca, etj.

Çështjet më kryesore ishin:

- Përfitimet në shëndet dhe rreziqet e aktivitetit fizik / programet e sportit për të gjithë
- Mosha moderne dhe grupet specifike të popullatës (njerëzit me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, njerëzit në varfëri, etj.) një sfidë e Sportit për të Gjithë
- Përcaktimi i nevojave të vëndeve në zhvillim në Sportin për të Gjithë
- Sporti për të Gjithë si rekreacion dhe si një formë e eksperiencës sociale dhe shprehjes kulturore
- Hartimi i strategjive dhe drejtimeve të sportit për të gjithë

29 Dhjetor 2006 – Takim Festiv Fundviti i KOKSH

Presidenti i KOKSH z. Hysen Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm z. Stavri Bello, patën kënaqësinë e veçantë të organizonin dhe të ftonin anëtarë dhe Miq të nderuar të Familjes Olimpikë Shqiptare në në "Takimin e Fundviti 2006" i cili u organizua në "House of Arts". Ky takim ishte i roganizuar në formën e një ceremonie kokteil për të vlerësuar bashkëpunimin dhe punën e përbashkët të bërë gjatë vitit 2006, si dhe për të qënë së bashku në pragvitin 2007!



Stavri Bello, Ela Tase (zv. presidente e KOKSH) Hysen Domi në përshëndetjen e rastit

11-13 Dhjetor 2006

KOKSH – Ambasada Franceze – CNOSF



KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR



KOKSH në bahskëpunim me Ambasadën Francezë në Tiranë, dhe Komitetin Olimpik e Sportiv Francez kanë organizuar me sukses seminarin me temë: "Aksesi I të rinjve në përgjegjësitë e drejtuesve". Ky seminar 2 ditor, i cili u zhvillua në Mjediset e AEFS "Vojo Kushi" në Tiranë, solli së bashku studentë të rinj të Akademisë së Sporteve, vullnetarë të rinj të lëvizjes Olimpikë dhe anëtarë të Komisionit të Sportistit të KOKSH.

Drejtuese të ftuara të këtij seminary ishin: znj. Dominique Petit, Drejtoreshë e Departamentit të Jetës së Shoqatave dhe znj. Myriam ANTOINE, Anëtare e Komisionit të të Rinjve Drejtues të Komitetit Olimpik Kombëtar Sportiv Francez (CNOSF)

Tematika e seminarit përfshinte :

- Organizimi i Sportit në Francë.
- Sfidat në rinovimin e vullnetarizmit
- Politika e të Rinjve drejtues në CNOFS



Nga ceremonia e çeljes së seminarit

- Prezantimi i mjeteve të trajnimit
- Debat, diskutime

KOKSH ka kënaqësinë t'ë promovojë një projekt të kësaj natyre aplikohet për herë të parë jashtë Francës, dhe si rrjedhojë e rëndësisë dhe aktualitetit të tematikave, Komiteti Olimpik Botëror synon ta vendosë atë në programin e tij të financimit.

Aktivite nga Federatat në vend

Federata e Radioamatorizmit

F.Sh.R. këtë vit ka zhvilluar veprimtari të shumta përveç atyre të planifikuara, kjo falë ndihmës së biznesmenëve që janë dashamirës të sportit tonë, dhe veçanërisht KOKSH i cili gjithnjë është ndodhur pranë sportit tonë. Me shumë kulturë e profesionalizëm janë zhvilluar veprimtaritë kombëtare për të rritur e të rinj, për meshkuj e Femra, po ashtu seminary kombëtar kualifikues me trainerë, takimi i veteranëve dhe i mjeshtrave të sportit. Në fund të këtij viti me ndihmën e MTKRS-së u bë i mundur zhvillimi kombëtar i Kupës së Republikës ku morrën pjesë Radioamatorët që kanë plotësuar normat ndërkombëtare të dhënies e marrjes i cili u kurorëzua me shumë sukses. Edhe këtë vit rekordmenët e mjeshtrat Miranda Mehmeti (Partizani) e Kujtim Çela (Krujë) u shpallën fitues të Kupës.


Lamtumirë Lorena Drenovcit...

Hedhësja e talentuar e Çekiçit, një ndër medalistet e të parave Lojra Olimpikë Rinore të Zhvilluara në Shqipëri u nda nga jeta në një moshë shumë të njomë.

Do t'u mungosh të gjithëve Lorena!



Federata Shqiptare e Dancit Sportiv – Kampionati VI Kombëtar



Kampionati VI i Kombëtar i Dansit Sportiv i zhvilluar në pallatin e sportit "Asllan Rusi" në datën 19/11/2006 solli në konkurim 250 sportistë nga 11 klube dhe shoqata të Dansit Sportiv. Kategori të grupmohave të ndryshme morën pjesë në dy disiplinat – Standarte dhe Latin Dance. Vlen të përmendet që ky aktivitet u gjykua një juri ndërkombëtare të kategorisë A dhe gjyqtar shqiptar.

Xhudo: Turneu I 6-të Mbarëkombëtar "Dita e Flamurit", Kosovë

Në datat 25-26 Nëntor 2006 u zhvillua në Gjilan të Kosovës Turneu Mbarëkombëtar "Dita e Flamurit" për kategorinë Kadet, Rinj dhe të Rritur për femra dhe meshkuj në Judo. Në këtë veprimtari të rëndësishme morën pjesë sportistë të ekipeve nga Kosova 6 ekipe, Shqipëria, shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnje Hercegovina. Turneu paraqiti nivel cilësor dhe një vlerësim të veçantë u dha për nivelin e Judistëve Shqiptarë.

Federata Shqiptare e Peshëngritjes - Kupa e Shqipërisë për të Rinj dhe të Rritur

Në qytetin e Vlorës FSHP zhvilloi në datat 5-6 Nëntor 2006 aktivitetin "Kupa e Shqipërisë 2006". Për femra morën pjesë 5 ekipe: Tirana, Teuta, Flamurtari, Dinamo dhe Albpetrol, gjithsej 10 sportiste.

FSHP është e vetmja Federatë që ka tre peshëngritës të kualifikuar për në "Pekin 2008" në kampionatin Botëror të Santo Domingos.

Duke faleminderuar **ALFLEXIM L.t.d.** për dizajnimin e këtij botimi informativ të **KOKSH** për gjatë gjithë vitit 2006, ju urojmë Gëzuar 2007.


THE WORLDWIDE OLYMPIC PARTNERS / PARTNERË M SHTRIRJE BOTËRORE



KOKSH - SPONSORËT LOKALË NË SHQIPËRI

Sponsorë Krenarë të Pjesëmarrjes së Shqipërisë në

"Torino 2006" (Lojrat Olimpikë Dimërore, edicioni XX)



Marketing Distribution



TIRANA INTERNATIONAL

Furnizues Zyrtarë:

